



**Hapet thirrja për mobilitete studentësh të UPT-së në kuadër të
Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus+
në Universidad Politécnica de Cartagena, Spanjë.**

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentë të Universitetit Politeknik të Tiranës, në Universidad Politécnica de Cartagena - UPC.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

Shkëmbimin e studentëve për studime: Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës; Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit; Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit.

Numri total i studentëve: 3

Koha e kryerjes së mobilitetit: Semestri i dytë i vitit akademik 2026-2027

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit (Academic transcript of records and achievement);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj* (English or Spanish Language Competency (B2 or higher according to the CEFR));
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

Bashkëlidhur keni një model të Learning Agreement.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në UPCT lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës. Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ te seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për t’u njohur me programet mësimore dhe lëndët që UPC ofron, klikoni te:

<https://international.upct.es/courses-in-english>

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 15 shtator 2026, ora 12.00.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al , abeqo@upt.al



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
- Mobility for learners -



Seleksionimi final bëhet nga UPC.



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

